Ligji vë theks të posaçëm tek zonat rurale për organizimin e debateve publike mbi projekt-aktet komunale të interesit publik.

Të gjitha propozimet për projekt-aktet komunale, të parashtruara nga banorët dhe grupet e interesit në takime publike, duhen shqyrtuar **brenda 15 ditësh**, nga data kur parashtrohen, si dhe t'i prezantohen Kuvendit Komunal.

Publikimi i akteve komunale

Komunat janë të obliguara të publikojnë dhe të mundësojnë qasjen në të gjitha aktet komunale, me përjashtime sipas përcaktimit të ligjit. Këto akte duhet të jenë të qasshme në mënyrë efikase; kryesisht duke i vendosur ato në faqet zyrtare të internetit. Ju mund t'i qaseni akteve komunale edhe me anë të ushtrimit të të drejtës për qasje në dokumente publike.

TË GJITHA AKTET KOMUNALE DUHET TË JENË TË QASSHME NË GJUHËT ZYRTARE DHE GJUHËT NË PËRDORIM ZYRTAR NË KOMUNËN TUAJ

Publikimi i akteve nënligjore komunale

Publikimi i akteve nënligjore komunale parashihet me rregulloren për hartimin dhe publikimin e akteve komunale. Me publikimin e tyre, plotësohet cikli i plotë i procesit ligjvënës komunal.

Kur hyjnë në fuqi aktet nënligjore komunale?

Aktet nënligjore komunale hyjnë në fuqi pas publikimit të tyre, si dhe nga data e paraparë në vetë aktin nënligjor komunal. Në raste përjashtuese, këto akte mund të kenë efekt prapaveprues, gjë që gjithashtu parashihet në vetë aktin nënligjor komunal.

SHËNIM! AKTET NËNLIGJORE KOMUNALE HYJNË NË FUQI 15 DITË NGA PUBLIKIMI I TYRE NË FAQEN ZYRTARE TË KOMUNËS

Publikimi i akteve nënligjore komunale në faqen zyrtare të internetit të komunës, në gjuhët zyrtare të komunës, është detyrim ligjor. Përveç kësaj, ato duhen publikuar edhe në kopje fizike/të shtypur.

Të gjitha aktet nënligjore komunale publikohen në një vegëz të posaçme, e cila mund të gjendet në faqen zyrtare të komunës, si në shembullin e mëposhtëm:
https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Assembly/Regulations.aspx

Projekt-aktet komunale gjithashtu mund të publikohen në një adresë të posaçme brenda faqes zyrtare, si në këtë shembull:
https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Assembly/Draft-rregulloret.aspx

Të gjitha aktet ligjore përkatëse mund të gjenden tek:
http://mapl.rks-gov.net/

QASJA NË AKTE KOMUNALE

Pjesëmarrja publike në hartimin e akteve komunale si dhe publikimi i tyre

osbe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Çfarë janë aktet komunale?

Komunat janë të autorizuara të hartojnë dhe miratojnë akte komunale, në bazë të ligjeve bazë dhe në përputhje me to, si dhe të nxjerrin akte që janë të domosdoshme për zbatimin e kompetencave vetanake të komunave.

Aktet komunale përfshijnë:

- *Aktet nënligjore komunale të miratuara nga kuvendi komunal, si dhe,*
- *Vendimet dhe udhëzimet e Kryetarit*

Aktet komunale zbatohen në territorin administrativ të komunës që i ka nxjerrë, si dhe kryesisht miratohen si vendime dhe rregullore komunale.

Çfarë janë aktet nënligjore komunale?

Aktet nënligjore komunale janë akte të karakterit të përgjithshëm dhe miratohen nga Kuvendi Komunal. Aktet e tilla janë:

- *Statuti i Komunës;*
- *Rregulloret;*
- *Vendimet;*

AKTET NËNLIGJORE KOMUNALE TË KARAKTERIT TË PËRGJITHSHËM ZBATOHEN PËR NJË NUMËR TË PAKUFIZUAR RASTESH DHE VLEJNË PËR TERRITORIN E CAKTUAR

Çfarë janë aktet nënligjore të karakterit të përgjithshëm?

Aktet nënligjore komunale të karakterit të përgjithshëm janë akte që rregullojnë çështje të interesit të përgjithshëm. Për shembull, nëse komuna juaj planifikon të ndërtojë një hapësirë parkimi apo të ngrejë një statujë në sheshin publik, këto akte janë të interesit të përgjithshëm publik.

Disa shembuj të akteve komunale të karakterit të përgjithshëm:

- *Plani rregullues urban komunal;*
- *Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave;*
- *Rregullorja komunale për taksat, tarifat dhe gjobat;*
- *Rregullorja komunale për përdorimin e gjuhëve;*
- *Rregullorja komunale për bashkëpunim me fshatrat dhe lagjet urbane;*
- *Rregullorja komunale për regjistrimin e bizneseve;*
- *Rregullorja komunale për licencimin e shoqërive tregtare;*
- *Rregullorja komunale për bursat e studentëve;*
- *Rregullorja komunale për ndarjen e banimit social;*
- *Rregullorja komunale për shërbimet e taksive;*
- *Rregullorja komunale për tatimin në pronë; etj.*

Me ligj, komuna obligohet të konsultojë publikun në hartimin e akteve komunale. Konsultimi i publikut dhe grupeve të interesit për projekt-aktet komunale është pjesë e procesit legjislativ të paraparë me ligj.

JU KENI TË DREJTË TË QASJES NË PROJEKT-AKTE NËNLIGJORE KOMUNALE NË FAZËN E HARTIMIT, PARA SE TË MIRATOHEN NGA KUVENDI KOMUNAL

Si konsultohet publiku mbi projekt-aktet komunale?

Mënyra më e shpeshtë e konsultimit publik për projekt-aktet komunale është përmes takimeve publike. Këto takime duhen organizuar në mënyrën që nxit pjesëmarrjen më të madhe publike. Gjegjësisht, komuna është e obliguar t'ju informojë mbi:

- Datën
- Vendin
- Orën
- Rendin e ditës

Dy javë para takimit, me anë të:

- Tabelave të njoftimit publik në vendet më të frekuentuara të qytetit dhe/ose fshatit
- Hapësirat e objektit të komunës.
- Mediat elektronike dhe shtyp.
- Faqet zyrtare të internetit të komunës.